



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 1687/2 prot.,

Datë 14.07.2023

**FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR**

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Medfau” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr.REF-67972-05-02-2023, me objekt: “*Loti 1, “Blerje kite dhe reagentë”* me fond limit 67.301.415,2 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 19.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal “Memorial” Fier.

Ankimues: “Medfau” SHPK
Rruga “4 Dëshmorët”, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Spitali Rajonal “Memorial” Fier
Fier

Në datën 14.07.2023, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1687 protokollit e operatorit ekonomik “Medfau” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr.REF-67972-05-02-2023, me objekt: “*Loti 1, “Blerje kite dhe reagentë”* me fond limit 67.301.415,2 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 19.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal “Memorial” Fier.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga “Medfau” SHPK.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, ku parashikohet se: “*Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:*

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “Medfau” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 1687 prot.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

Vlerësimi për OE Medfau:

1. Nuk plotesohet Kriteri 1.c - Nuk është paraqitur Formulari Permbledhes i Vetedeklarimit sipas Shtojces 8 si ne forme ashtu edhe ne permbajtje. Qendrim i mbajtur edhe nga KPP me Vendimin nr.183 dt.09.03.2023.

2. Nga kerkesat per pajisjet ne perdorim, nuk plotesohet pika c “autorizimi i prodhuesit” - Eshte ofruar pajisja Koagulometer CA 600 e prodhuesit Siemens, ndersa Autorizimi i Prodhuesit eshte per pajisjen Koagulometer CA 560.

3. Nuk permbushen specififikimet teknike te kerkuara per pajisjet ne perdorim si vijon:

3.1. Pajisja Analizator Imunologjik: Modeli Advia Centaur XPT e ofruar si pajisje primare dhe si pajisje back-up, nuk ploteson specififikimet: (i) Si pajisje primare, nuk ploteson “Sistem imuno-analizues i automatizuar i cili bazohet ne parimin CMLA” - ofruar me metodologjine e kemiluminishences kimike; (ii) Si pajisje back-up, nuk ploteson “Sistem imuno-analizues i automatizuar i cili bazohet në parimin ELFA”.

3.2. Pajisja Analizator Hematologjik: Modeli Advia 560 e ofruar si pajisje primare dhe si pajisje back-up, nuk ploteson specifikimin “Vëllimi maksimal i mostrës 15 µl” – pajisja e ofruar ka vellim maksimal te mostres 110 µl.

3.3. Pajisja Analizator per Gazet ne Gjak: Modeli Rapid Poit 500, nuk ploteson specifikimin “Mostra e perdorur: 2-3 pika gjak i plote ose plasme”.

3.4. Pajisja Analizator Koagulimi, është ofruar modeli CA 600 por nuk ka autorizim prodhuesi per kete model por per modelin CA 560. Sidoqofte, edhe modeli CA 600 i ofruar, nuk ploteson specififikimet e kekrkuara, konkretisht: (i) “Aparati back up gjysëautomatik” – ofruar të dy aparatet automatik; (ii) “Metodologjia: Sistemi i detektimit I bazuar ne viskozitet” – ofruar Photo-optical, continuous, sequential (Clotting/4, chromogenic, * and immunologic*); (iii) “Kapaciteti rreth 100 mostra” – max i ofruar nga pajisja është 60; (iv) “Te ofroje mundesine e analizimit prioritar te mostrave STAT” – ofron vetem 1(STAT 1 priority position); (v) “Te jete i paisur me te pakten 4 kohemates te inkorporuar ne aparat me alarm zanor” – nuk e ofron.

3.5. Pajisja Analizator Biokimik: Modeli Dimension EXL 200, e ofruar si pajisje primare dhe si pajisje back-up, si pajisje primare nuk ploteson specifikimin “Kapaciteti jo me pak se 800 teste/ore”.

3.6. Pajisja Analizator Urine: Model i ofruar Clinitec Status, nuk ploteson specifikimin “Kapaciteti rreth 600 stripe urine/ore”.

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 14.07.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri